



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 717/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.10.2018, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF- 73463-06-05-2018, me objekt: “*Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga Kuben - Vasie 35.4 km*”, me fond limit 44.534.152 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 04.07.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër”.

Ankimues: Operatori ekonomik “Curri” sh.p.k.
Rr. “Kajo Karafili”, Nd. 2, H. 4, Ap. 3, Nj. Bashkiake Nr.10, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër
Lagja “3 Heronjtë”, Rr. “At Zef Valentini”, Shkodër

Subjekti i interesuar: Operatori ekonomik “Alko Impex General Construcion” sh.p.k.
Rr. “Reshit Petrela”, Kompleksi “Usluga”, Kati 8, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 06.06.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-73463-06-05-2018, me objekt: “Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga Kuben - Vasie 35.4 km”, me fond limit 44.534.152 lekë (pa TVSH).

II.2. Në datën 04.07.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

Referuar informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor, në këtë procedurë prokurimi, kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

- | | | |
|----|--|-----------------------------------|
| 1. | “Curri” sh.p.k. | 30.220.926 lekë, skualifikuar |
| 2. | “Selami” sh.p.k. | 37.852.747 lekë, skualifikuar |
| 3. | “Alb Shpresa” sh.p.k. | 39.000.000 lekë, skualifikuar |
| 4. | “Alko Impex General Construcion” sh.p.k. | 40.450.292 lekë, kualifikuar |
| 5. | Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Doda Ndërtim” sh.p.k.
& “Euraldi” sh.p.k. | 43.373.053 lekë, skualifikuar |
| 6. | ”Adem Pojani” person fizik | nuk ka paraqitur ofertë ekonomike |

II.3. Në datën 25.07.2018 operatori ekonomik “Curri” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyet si më poshtë vijon:

Nuk plotësoni kushtet për kualifikim për sa ju përket mjeteve/makinerive, pasi këto mjete janë të njëjta me mjetet e përdorura në prokurimin me objekt “Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga “Lezhë-Nënkalimi Milot, Lidhja e 2 urave-K/Pllanë - U.Zogut, Lezhë H.Gjuetisë, Vain-Bilanc, U.Drojes-Milot, Laç- Patok, Balldre-B Juges 77.85 km”, në të cilin jeni kualifikuar dhe renditur i pari, prandaj mjetet tuaja rezultojnë të angazhuara në kundërshtim me atë që është përcaktuar në kriteret për kualifikim.

II.4. Në datën 31.07.2018, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, ku kundërshton skualifikimin e ofertës së tij, duke pretenduar si më poshtë vijon:

[...] Së pari renditja i pari në procedurën e prokurimit nga ana juaj, nuk do të thotë që ne jemi fitues dhe kemi lidhur kontratë. Pra ne nuk kemi një kontratë të lidhur me autoritetin kontraktor që ju ta përdorni si arsye për të thënë që makineritë janë të angazhuara në kontrata të tjera.

Referuar pikës 2.3.8. të DST sipas së cilës citojmë:

2.3.8. Makineritë e mësipërmet nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera. Për këtë të paraqitet një deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese se makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera për të gjithë periudhën e përcaktuar si afati i kryerjes së shërbimit. Pra edhe në DST ju vetë keni përcaktuar, që nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera por,

Së dyti, këto janë dy procedura prokurimi të shpallur më vehte dhe nuk kanë lidhje me njëra tjetrën. Ju duhet të kualifikoni ofertën tonë, dhe pastaj ju lind e drejta të thërrisni operatorin ekonomik dhe është ai i cili duhet të zgjedhë se për cilën prej procedurave do të lidhim kontratë me autoritetin kontraktor. Autoriteti kontraktor nuk mund dhe nuk duhet të imponojë këtë zgjedhje në mënyrë të njëanshme.

Në këto kushte kjo arsye nuk ekziston dhe nuk duhet të përdoret si arsye skualifikimi.

Ky vlerësim i bërë nga KVO nuk është aspak profesional dhe ligjor.

Ne kërkojmë kuotimin e ofertës tonë në këtë procedurë prokurimi [...]

II.5. Me shkresën nr. 324 prot., datë 06.08.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimes duke mos e pranuar ankesën, ndërkohë që ankimesi pretendon se në datën 09.08.2018, është njohur me kthimin e përgjigjes nëpërmjet shërbimit postar.

Konkretisht autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes argumenton si më poshtë vijon:

[...]Pas verifikimit të dokumentacionit nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të ankesave rezulton se ju keni paraqitur identik të njëjtat mjete për tre procedura konkretisht për objektet: “Lezhë – nënkalimi Milot, Lidhja e 2 urave – K/Pllanë- U. Zogut, Lezhë – H. Gjuetisë, Vain – Bilanc, U. Drojes – Milot, Laç – Patok, Balldre – B Juge 77.85 km”; për objektin “Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga Kuben – Vasie 35.4 km”, dhe për objektin “Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga Peshkopi - Q. Draje, Peshkopi – Ushtelencë 52.7 km”.

Nga ana e KVO-së ju jeni klasifikuar si ofertues i suksesshëm bazuar në kriterin: çmimi më i ulët i ofruar si dhe faktit që plotësoni kriteret e kualifikimit për objektin; si rrjedhim fitues referuar edhe nenit 21 të VKM – së për objektin “Lezhë – nënkalimi Milot, Lidhja e 2 urave – K/Pllanë- U. Zogut, Lezhë – H. Gjuetisë, Vain – Bilanc, U. Drojes – Milot, Laç – Patok, Balldre – B Juge 77.85 km”, vlerësimi për të cilin ka përfunduar më herët se për objektin për të cilin ju keni bërë ankesë. Neni 30/4 i LPP-së përcakton se autoriteti kontraktor (me anë të KVO-së) hap ofertat, verifikon kualifikimet apo mangësitë e ofertuesve, në bazë të kriterëve të përcaktuara në nenet 45 e 46 të këtij ligji dhe përzgjedh kontratën fituese, pas krahasimit të ofertave, bazuar në kriteret e përcaktuara në nenin 55 të këtij ligji dhe po sipas nenit 55 ju përmbushni të gjitha kriteret ligjore për të qenë fitues.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se paraqitni të njëjtat mjete për 3 procedura me objekte dhe vendndodhje të ndryshme nga njëri – tjetri dhe natyrshëm lind pyetja sesi do mbulohen 3 objekte njëkohësisht thjeshtë duke iu referuar faktit që ju përdorni apo paraqisni dokumentacion për të njëjtat borëpastruese të njëjtët kamionë etj për secilën procedurë.

Aksi Kuben – Vasije në stinën e dimrit paraqet vështirësi në qarkullim për shkak të borës dhe ngricave, borëpastrueset janë mjetet thelbësore për kryerjen e kësaj pjese të kontratës. Këto mjete shërbejnë për pastrimin e rrugës në rastet e reshjeve nga dëbora dhe për hedhjen e kripës në rast ngricash. Nisur nga specifikat e objektit kur rreshjet e dëborës bien njëtrajtësisht në të gjithë objektin dhe nisur nga eksperiencat e kaluara është parashikuar që nevojitet 1 mjet borëpastruese për mesatarisht 15 km mirëmbajtje dimërore.

Për të realizuar një shërbim sipas kushteve teknike për largimin e dëborës nga karrexhata me një borëpastruese mund të mbulohet një korsi e rrugës. Me shpejtësinë 10-20 km në orë me të cilën lëvizin borëpastrueset mund të realizohet pastrimi në një gjatësi prej rreth 30 km të njëjës korsi ose rreth 15 km të rrugëve nacionale që janë me dy kors. Prandaj duke u nisur nga gjatësia e aksit në fjalë prej 35.4 km (dhe duke u nisur nga fakti se sasi e reshjeve të dëborës është shumë e madhe në këtë zonë për vetë pozicionin gjeografik të saj) janë parë të nevojshme 2 borëpastruese. Aksi i Peshkopisë kërkon 4 borëpastruese, aksi i Lezhës 1 borëpastruese, Kuben – Vasije 2 borëpastruese, totali 7 borëpastruese në pronësi / qera. Ju nën cilësinë e operatorit ekonomik nuk i keni. Këto mjete duhen të jenë gjithmonë aktive në një segment, dhe nëse i angazhoni në objektin ku ju jeni fitues, akset e tjera mbesin të pambuluara.

Nga sa më sipër, [...] vlerësimi i bërë nga KVO për subjektet në fjalë cilësohet i ligjshëm, konform të gjitha kriterëve të kualifikimit.

II.6. Në datën 16.08.2018, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke ngritur pretendimet si më poshtë vijon:

[...] Së pari renditja i pari në procedurën e prokurimit nga ana juaj, nuk do të thotë që ne jemi fitues dhe kemi lidhur kontratë. Pra ne nuk kemi një kontratë të lidhur me autoritetin kontraktor që ju ta përdorni si arsye për të thënë që makineritë janë të angazhuara në kontrata të tjera.

Referuar pikës 2.3.8. të DST sipas së cilës citojmë:

2.3.8. Makineritë e mësipërmet nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera.

Për këtë të paraqitet një deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese se makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera për të gjithë periudhën e përcaktuar si afati i kryerjes së shërbimit. Pra edhe në DST ju vetë keni përcaktuar, që nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera por,

Së dyti, këto janë dy procedura prokurimi të shpallur më vehte dhe nuk kanë lidhje me njëra tjetrën. Ju duhet të kualifikoni ofertën tonë, dhe pastaj ju lind e drejta të thërrisni operatorin ekonomik dhe është ai i cili duhet të zgjedhë se për cilën prej procedurave do të lidhim kontratë me autoritetin kontraktor. Autoriteti kontraktor nuk mund dhe nuk duhet të imponojë këtë zgjedhje në mënyrë të njëanshme.

Në këto kushte kjo arsye nuk ekziston dhe nuk duhet të përdoret si arsye skualifikimi.

Përgjigja e autoritetit kontraktor.

Me shkresën nr. 324 prot., datë 06.07.2018 (me të cilën jemi njohur në datën 09.08.2018 nëpërmjet shërbimit postar), autoriteti kontraktor përveç justifikimit që ka bërë KVO në kuotim, ka mbështetur skualifikimin edhe me një arsyetim tjetër absurd që lidhet me disponueshmërinë e mjeteve në stinën për tre kontratat ku ne kemi ofertat tona.

Ky arsyetim është absurd dhe nuk qëndron. Autoriteti kontraktor kualifikon ofertën mbi bazën e dokumentave të paraqitura në procedurën e prokurimit pa bërë lidhje dhe interferime midis procedurave të ndryshme.

Nëse ju bën këto lidhje dhe interferime midis 3 procedurave të ndryshme të prokurimit, atëherë më mirë ti kishit prokuruar në një procedurë të vetme dhe të vendosni kriteret kumulative.

Autoriteti kontraktor nuk ka asnjë të drejtë të paragjykojë mënyrën se si ne do të realizojmë kontratën. Ai është i detyruar të shpallë fitues ofertën më të ulët, referuar kriterëve për këtë procedurë dhe të lidhë kontratën. Kontrata ka penalitete. Nëse ne si kontraktor nuk zbatojmë kontratën dhe nuk arrijmë të performojmë si duhet në mirëmbajtjen si gjatë periudhës së thatë po edhe gjatë dimrit, ju si autoritet kontraktor keni mekanizmat e kontrollit dhe të penalizimit.

Por në asnjë mënyrë të mund të shpallni 3 procedura prokurimi të ndryshme me kriteret përkatëse dhe më pas të bëni lidhje mes tre procedurave vetëm e vetëm pse ju jeni i njëjti autoritet kontraktor. Konstatim – standard i dyfishtë e vlerësimit të KVO dhe autoritetit kontraktor.

Nga verifikimet tona kemi konstatuar që autoriteti kontraktor aplikon standarde të dyfishta në vlerësimin dhe kuotimin e ofertave. Psh shoqëria “Selami” sh.p.k. e kualifikuar e para në procedurën e prokurimit Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga Peshkopi – Q. Draje, Peshkopi – Ushtelencë 52.7 km”, gjithashtu është kualifikuar me ofertë të vlefshme edhe në një procedurë tjetër prokurimi “Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga Ura e Cerencit – Steblevë, Qafa e Buallit – Krastë, burrel – Koms, Ura e Matit – Lis, K/ulës – Ulëz, Trebisht – Doganë 75.92 km”, me të njëjtat makineri.

Bashkëlidhur gjeni kopje të shtojcës së deklaramit të makinerive të deklaruar në këto dy procedura prokurimi nga shoqëria “Selami” sh.p.k. jeni të lutur të bëni verifikimet përkatëse dhe do të konstatooni këtë fakt. Kjo tregon qartë se autoriteti kontraktor përdor dy standarte në vlerësim dhe punon me preferenca të caktuara.

[...]

I shprehur që në nenin 1 të ligjit të prokurimit publik, qëllimi i procedurave të prokurimit publik është të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin e përdorimit të parave publike, të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit dhe të nxisë konkurrencën e të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedura prokurimi.[...].

II.7. Në datën 30.08.2018, nëpërmjet shkresës me nr.360 prot., datë 28.08.2018, me objekt: “*Kthim përgjigje*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të tij nga procedura e prokurimit objekt shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 8, pika 3.3. Kapaciteti teknik, pika 2.3.7., nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar kriteri: “*2.3.7 Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontrates. Për këto duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe makinerite që ka në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik. Kerkohen të jenë në dispozicion këto mjete pune:*

Nr	Lloji i Makinerive	Pronësia	Sasia
1	<i>Mjet transporti vetëshkarkues (kamion 8-12ton)</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
2	<i>Grejder</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
3	<i>Rrul vibrues</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
4	<i>Prerëse asfalti</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
5	<i>Autobetoniere</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
6	<i>Asfaltoshtruese</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
7	<i>Mjet për vendosje parrakesh metalik (guardrails)i Batipal</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>

8	Borepastruese	në pronësi ose me qira	Copë 2
9	Kamioncine mbi 1 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
10	Fadrome 0.4-1 m3	në pronësi ose me qira	Copë 1
11	Ekskavator me zinxhir 0.4-1 m3	në pronësi ose me qira	Copë 1
12	Fabrike Asfaltobetoni, e pajisur me QKL, leje mjedisore ose (kontrate furnizimi per asfaltobeton).	pronësi /qira/furnizim	Copë 1
13	Set semaforesh per menaxhim trafiku	pronësi /qira/furnizim	Copë 1

Operatori te paraqese nje deklarate sipas shtojces Nr.9. Deklarata e mesiperme eshte objekt verifikimi dhe kontrolli ne cdo kohe deri ne realizimin e plote te kontrates.

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë kur janë në pronësi duhet të paraqitet: dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit leje qarkullimi (leshuar nga autoritetet kompetente në Shqipëri), çertifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (i vlefshëm).
- b) Per mjetet qe nuk shenohen ne regjistra publike, kur janë në pronësi duhet të paraqitet kontrata e blerjes, c' doganimi në Shqipëri ose (kalimi në regjim të perkohshme) dhe faturat tatimore perkatese.
- c) Për mjetet e siguruara me qira duhet të paraqitet: dokumenti që verteton regjistrimin e tij, leje qarkullimi (leshuar nga autoritetet kompetente në Shqipëri) çertifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (i vlefshëm). Mjetet të shoqerohen me kontraten noteriale perkatese të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontrates, (te deklarohet nga qiradhenesi që mjete nuk i është dhënë me qira ndonjë subjekti tjetër) ku të specifikohet objekti i prokurimit në fjalet si dhe afati i saj.
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 9. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).
- f) Per sa ju perket mjetve borepastruese duhet te jene te paisura me kripore dhe thike (ku te komandohen nga brenda kabines nga manovratori) dhe (jo te jene te improvizuara si mjete borepastruese duke bere bashkim pjesesh per te improvizuar borepastruese).
- g) Per mjetet borepastruese ne lejet e qarkullimit te tyre duhet te jete e cilesuar si APV (automjet i perdorimit te vecante).
- h) Mjetet borepastruese duhet te shoqerohen minimalisht me nga dy foto ku te dallohen qartesisht edhe target e mjetit dhe pasijet e saj si kryporja dhe thika.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vertetesine e deklarates. Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Per Prokurimin Publik".

Në pikën 2.3.8. po këtu, nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar kriteri:

2.3.8 Makinerite e mesiperme nuk duhet të jene të angazhuara në kontrata të tjera. Për këto të paraqitet një deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese se makinerite e mesiperme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera për të gjithë periudhën e përcaktuar si afati i kryerjes së shërbimit

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vertetesine e deklarates. Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Per Prokurimin Publik".

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik "Curri" sh.p.k., konstatohet se është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm:

Operatori ekonomik "Curri" sh.p.k. ka paraqitur:

- Deklaratë për kontratat e lidhura apo në proces, ku asnjëra prej tyre nuk rezulton të jetë kontratë e lidhur me Drejtorinë e Rajonit Verior Shkodër;
- Deklaratë për kapacitetet teknike në dispozicion të realizimit të kontratës, ku deklarohet: *"Makineritë e deklaruara në këtë procedurë prokurimi nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në kontratat të tjera për të gjithë periudhën e përcaktuar si afat i kryerjes së shërbimit"*;
- Deklarata për disponimin e makinerive e pajisjeve.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese"*.

III.1.5. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, parashikohet: *"Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit..."*.

III.1.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

Operatori ekonomik "Curri" sh.p.k. ka paraqitur dokumentacionin e duhur në përmbushje të kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, sipas së cilës është paraqitur deklarata përkatëse, nëpërmjet të cilës, deklaroi se, makineritë sipas kërkesave të tenderit nuk janë dhe nuk do të jenë të angazhuara në kontrata të tjera për të gjithë periudhën e përcaktuar në dokumentat e tenderit si afati i kryerjes së shërbimit.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, thjesht e vetëm fakti i evidentuar nga autoriteti kontraktor se ky operator ekonomik është shpallur fitues dhe është kualifikuar duke u renditur i pari edhe në disa procedura të tjera, nuk mund të shbëjë deklaratën e administratorit të shoqërisë “Curri” sh.p.k. për angazhimin e mjeteve të deklaruara në rast se shpallet fitues për procedurën në fjalë, e aq më pak të shërbejë automatikisht si shkak skualifikimi, ndërkohë që, faktikisht, referuar kriterit të përcaktuar në dokumentat e tenderit nga vetë autoriteti kontraktor, ky i fundit nuk disponon një kontratë të lidhur për procedurat e tjera të prokurimit të cituara nga po vetë autoriteti kontraktor në arsyen e skualifikimit.

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetë cilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje se, referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e punimeve është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Sa më sipër analizuar, konstatojmë se, jemi përpara rastit klasik kur nga ana e operatorit ekonomik ankimues është plotësuar kërkesa e përcaktuar në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor në lidhje me angazhimin e mjeteve, pasi, në rastin konkret operatori ekonomik ankimues nuk disponon aktualisht asnjë kontratë të lidhur me këtë autoritet.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se, operatori ekonomik ankimues, bashkëngjitur dokumentacionit shtesë të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si pjesë të ankesës me nr. 1404 prot., ka dorëzuar edhe dokumentacion të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt ankimi, konkretisht operatorit ekonomik “Selami” sh.p.k. si më poshtë vijon:

1. Fotokopje të pa noterizuar të Shtojcës Mbi deklarimin e makinerive për procedurën e prokurimit me objekt “Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga Peshkopi-Q. Draje, Peshkopi – Ushtelencë 52.7 km”, të shoqërisë “Selami” sh.p.k. vulosur me vulën e shoqërisë “Selami” sh.p.k.
2. Fotokopje të pa noterizuar të Shtojcës Mbi deklarimin e makinerive për procedurën e prokurimit me objekt “Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga Ura e Cerencit – Steblevë, Qafë Bualli – Krastë, Burrel – Komësi, Ura e Matit – Lis; K/ULëz – ULëz; Trebisht – Doganë 75.92 km”, të shoqërisë “Selami” sh.p.k., vulosur me vulën e shoqërisë “Selami” sh.p.k.

III.2.1. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se ankimuesi, në ankesën dorëzuar pranë këtij të fundit, ka dorëzuar dokumentacion konfidencial, në kuptim të nenit 25 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili disponohet vetëm në sistemin e prokurimeve elektronike. Në nenin 25 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “Pa cenuar dispozitat e këtij ligji mbi detyrimin për botimin e kontratave të prokurimit dhe të informacioneve për kandidatët dhe ofertuesit, sipas neneve 21 e 57 të këtij ligji, autoriteti kontraktor nuk duhet të bëjë publik informacionet e marra nga operatorët

ekonomikë, të etiketuara si konfidenciale. Ky lloj informacioni përfshin veçanërisht aspektet teknike, sekretet tregtare dhe informacionet konfidenciale të ofertave”.

Referuar informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor, si edhe trajtimit të ankesës së subjektit ankimes, konstatohet se ky i fundit, në asnjë rast nuk ka marrë dijeni në formë zyrtare pranë autoritetit kontraktor në lidhje me dokumentacionin e mësipërm.

Sa më sipër, KPP konstaton se fshehtësia e procesit të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, i parashikuar dhe nga *lex specialis*, shfaq një rëndësi të veçantë si në drejtim të mbrojtjes së nivelit më të lartë të interesit publik, por njëherazi shfaq edhe nivelin më të lartë të mbrojtjes së garancive procedurale të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në drejtim të ruajtjes së sekretit tregëtar, të dokumentacionit të dorëzuar nga këto të fundit në procedurat e prokurimit publik. Akoma më tej, KPP gjykon se, cënimi i fshehtësisë së procesit zhvilluar, me anë të së cilës, pjesëmarrësit në procedurat e prokurimit publik marrin dijeni në një formë të ndryshme nga ajo e caktuar në ligjin për prokurimin publik, mbi natyrën e kontratave të punësimin të stafit, llojit të tyre, listëpagesave të shoqërisë ku shfaqen të dhëna konfidenciale të punonjësit, numri i sigurimeve shoqërore, pagesa mujore (paga), lloji dhe natyra e kapaciteteve teknike të disponuara të konkurrentëve, cilësohet shkelje e sekretit tregëtar të kompanive, me anë të së cilit, përhapet informacion konfidencial i subjekteve tregëtare tek persona të paautorizuar, informacion i cili, jo vetëm i shkakton dëm interesave tregëtare të shoqërive, por njëherazi, cënon edhe procesin e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik.

III.2.2. Të ndodhur në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, shqyrtimi i çështjeve të mësipërme është jashtë kompetencës lëndore të këtij të fundit. Referuar nenit 19/1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se “Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj”. Sa më sipër, referuar materialeve të administruara, Komisioni i Prokurimit Publik, në zbatim të nenit 13 të *lex specialis*, i propozon Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimit administrativ në lidhje me konstatimet e mësipërme.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Curri” sh.p.k., për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF- 73463-06-05-2018, me objekt: “Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga Kuben - Vasie 35.4 km”, me fond limit 44.534.152 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 04.07.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër.

2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k. dhe të korrigojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. T’i propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimit administrativ për konstatimet e mësipërme, si edhe të dërgohet pranë APP-së kopje e materialeve të administruara në shqyrtimin administrativ nr. 1404 prot., datë 16.08.2018.
5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Curri” sh.p.k.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1404 Protokolli

Datë 16.08.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha